

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA GJIROKASTER KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përherëshëm i Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 09 datë 26.11.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit “ Për miratimin e Paketës Fiskale 2026 në Bashkinë Gjirokastër”, datë 27.11.2025 relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin:

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

- 1.Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Ky ligj përbën bazën themelore për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë. Ai përcakton qartë funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e këtyre njësive dhe të organeve përkatëse.
- 2.Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar. Ky ligj rregullon çështjet që lidhen me parimet dhe procedurat për financimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, të ardhurat vendore, përfshirë taksat, tarifat, transfertat dhe burimet e tjera të përcaktuara me ligj, ndarjen dhe menaxhimin e transfertave nga qeveria qendrore si edhe politikat dhe instrumentet për menaxhimin e financave publike në nivel vendor.
- 3.Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar Ky ligj përcakton procedurat dhe rregullat për ushtrimin e të drejtës së vendosjes, mbledhjes dhe administrimit të taksave e tarifave vendore nga organet e qeverisjes vendore.
- 4.Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji përcakton strukturën dhe parimet e funksionimit të sistemit

buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë institucionale për zbatimin e legjislacionit buxhetor.

5.Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Parashikimi i të ardhurave përbën shtyllën themelore mbi të cilën ndërtohet menaxhimi i qëndrueshëm financiar i çdo njësie të vetëqeverisjes vendore. Ai nuk është një proces thjesht teknik ose kontabël, por një mekanizëm strategjik që ndikon drejtpërdrejt në stabilitetin fiskal, kapacitetin e financimit të shërbimeve publike, realizimin e investimeve kapitale, si dhe në vetë besueshmërinë e institucioneve vendore ndaj qytetarëve dhe aktorëve lokal. Në thelb, parashikimi i të ardhurave duhet të shërbejë si “hartë orientuese” për të gjitha vendimmarrjet buxhetore dhe fiskale.

Për këtë arsye kërkohet jo vetëm analizë historike, por edhe projeksione realiste mbi bazën e trendeve ekonomike lokale dhe kombëtare, treguesve të konsumit dhe aktivitetit të biznesit, ndryshimeve në politikat tatimore dhe tarifore, kapaciteteve administrative të bashkisë, verifikimit të bazës së tatimpaguesve, digjitalizimit të proceseve të mbledhjes dhe faktorëve demografikë e socialë.

Një parashikim i ndërtuar në këtë mënyrë rrit saktësinë në projeksion dhe shmang rreziqet e mbivlerësimit apo nënvlerësimit të të ardhurave, të cilat mund të çojnë në deficit të panevojshëm, pengesa në financimin e projekteve, ose vonesa në pagesa për shërbime jetike.

Në funksion të mirëadministrimit dhe planifikimit të qëndrueshëm financiar, njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështeten në një kuadër të gjerë ligjor, i cili përcakton strukturën organizative, kompetencat, burimet financiare dhe procedurat administrative të tyre.

Ky kuadër përfshin aktet që vendosin bazat e funksionimit të qeverisjes vendore, rregullojnë financat publike në nivel lokal, si dhe trajtojnë të ardhurat nga taksat, tarifët dhe transfertat. Gjithashtu, janë të përcaktuara qartë rregullat për administrimin e taksave vendore dhe marrëdhëniet financiare ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Rregulloret për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme dhe udhëzimet për hartimin e programeve buxhetore afatmesme kontribuojnë në përmirësimin e menaxhimit financiar. Vendimet e këshillit bashkiak konkretizon këtë legjislacion në praktikë, duke miratuar strukturën e të ardhurave, shpenzimeve dhe programeve zhvillimore. Zbatimi i saktë dhe i koordinuar i këtij kuadri është thelbësor për një administrim efikas, garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe përdorimit eficient të burimeve publike në funksion të zhvillimit lokal dhe përmirësimit të shërbimeve për qytetarët.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

1. Parashikimi i të ardhurave nga burimet e veta

Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.

Të ardhurat nga burimet e veta, bazohen kryesisht në:

1. Taksat vendore

- a) mbi pasuritë e luajtshme e të paluajtshme
- b) taksat e ndikimit në infrastrukturë
- c) mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier
- d) taksa vendore të përkohshme
- e) taksa të tjera të përcaktuara me ligj

2. Tarifat vendore

a) nga shërbimet publike që NJVV ofron

- Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve,
- Tarifa arsimore, kulturore dhe shërbimeve të tjera
- Tarifa për shërbimet administrative

b) nga e drejta e përdorimit të pronës publike

- Tarifa për zënieën e hapësirave publike,
- Tarifa e parkimit të automjeteve.
- Tarifa për menaxhimin e pyjeve, kullotave dhe kanaleve vaditëse

c) nga dhënia e liçencave, lejeve dhe autorizimeve

- Tarifa për liçenca

ç) nga tarifa të tjetëra të përkohshme

3. Të ardhura nga burime të tjera

Të ardhurat e bashkive mund të vijnë dhe nga një sërë burimesh të tjera të natyrës ekonomike, pronësore dhe financiare, të cilat ndihmojnë në fuqizimin e buxhetit vendor

dhe në ofrimin e shërbimeve për komunitetin.

Në këtë grup, burim i rëndësishëm janë të ardhurat nga dhënia me qira e asetëve në pronësi të bashkisë, përfshirë ambiente, toka apo struktura të tjera, që përdoren nga persona juridikë ose fizikë kundrejt pagesës.

Miratimi i paketës fiskale mbyll procesin e parashikimit dhe hap fazën e monitorimit të realizimit të të ardhurave të veta, zhvillimit të shpenzimeve buxhetore dhe vlerësimit të performancës institucionale kundrejt komunitetit.

Drejtoria / Sektori përgjegjës :

Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Kmisioni i Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Këshilli Bashkiak, sipas pershkrimeve ligjore dhe sa herë ai e shikon të nevojshme.

Impakti social / grupet që preken:

Ky projekt vendim impakton te gjitha shtresat dhe kategorite e komunitet te bashkisë Gjyrokaster, komunitetin e biznesit si dhe zhvillimin ekonomik të krejt territorit te kësaj bashkie.

A është objekt i konsultimit publik:

PO

Komisioni i Përhershëm i i “Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”

i mbledhur me datën 26.11.2025, shqyrtoi projekt vendimit “ Për miratimin e Paketës Fiskale 2026 në Bashkinë Gjyrokastër 2025, relacionit e dokumentat shoqërues në me propozimin:

paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.


Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni me shumicë votash,

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
 - ✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
 - ✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
 - ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
 - ✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në "-----"

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Mevide Shehaj  **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

MIHARE LAPA  **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Datë 26 /11 / 2025